



Për: Grupin Monitorues

Për vëmendjen e Z. Gerben Everts, Kryetar

9 Shkurt 2018 Prishtinë, Kosovë

**Përgjigje ndaj dokumentit konsultativ të grupit të monitorimit për forcimin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së bordeve të përcaktimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit në interes publik**

I nderuari Zotëri/Zonjë,

Përgjigjet e Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës si anëtare e plotë në FNK, përfaqësojnë një gamë të gjerë perspektivash përfshirë ato të profesionit të auditimit, PVM-ve dhe kontabilistëve profesionistë në biznes në ekonominë e Kosovës. ShKÇAK mirëpret mundësinë për të komentuar mbi [dokumentin konsultativ për forcimin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së bordeve të përcaktimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit në interesin publik](#).

Si pjesë e ekonomisë tranzicionale në Kosovë, përvoja jonë si ShKÇAK është se një qeverisje dhe mbikëqyrje e fortë luan një rol vendimtar në zhvillimin e profesionit dhe gjithashtu në procesin e vendosjes së standardeve. Një adoptim i gjerë botëror i standardeve ka dëshmuar se procesi aktual i përcaktimit të standardeve është transparent dhe i shërben interesit publik. Ne besojmë fuqimisht që procesi i vendosjes së standardeve duhet të organizohet në mënyrë që të shmanget ndonjë konflikt interesi dhe rregullat duhet të përforcohen me qëllim që të sigurohet pavarësia e plotë e procesit të vendosjes së standardeve. Në këtë drejtim, ne mendojmë se ndarja e funksioneve të qeverisjes dhe mbikëqyrjes, përfshirja e palëve të interesit më të gjera që përfaqësojnë grupet me aftësi të përshtatshme do të sigurojnë një proces efikas dhe transparent në interes të publikut.

**PIKAT KRYESORE**

***Niveli i reformës së nevojshme dhe një rrugë përpara***

Sipas mendimit tonë, struktura e tanishme tri-shtresore është forma e duhur e mbikëqyrjes. Ne nuk do të avokojmë, për shembull, të bashkonim aktivitetet e BMIP-së dhe GM-së, pasi kjo do të ngatërronte rolet e tyre të mbikëqyrjes dhe monitorimit dhe do të rrezikonte politizimin më të madh të vendosjes së standardeve. Qëllimi duhet të jetë për të komunikuar më mirë atributet pozitive të strukturës aktuale, duke marrë në konsideratë se si besimi i palëve të interesuara në marrëveshjet mund të rritet më tej. Kështu, ne besojmë se modeli aktual është i mbikëqyrur mjaftueshëm dhe nuk jep vend për nën ndikim nga profesioni dhe asnjë palë e interesuar nuk duhet të ushtrojë ndikim të panevojshëm në borde.



Modeli aktual i përcaktimit të standardeve ka siguruar që standardet janë zhvilluar në interesin publik pasi që janë miratuar globalisht nga legjislatorët, rregullatorët dhe i kanë shërbyer interesit publik. Procesi i vendosjes së standardeve është mbikëqyrur nga BMIP-ja.

Struktura aktuale e përcaktimit të FNK-së u hartua në kontekstin e arkitekturës më të gjerë globale në të cilën vepron. Ne besojmë se struktura aktuale ofron standarde të larta në kontekstin e raportimit financiar, qeverisjes korporative dhe normave rregullatore që aktualisht mbizotërojnë në tregjet e kapitalit.

Por arkitektura ndërkombëtare dhe pritjet e publikut evoluojnë dhe gjithashtu asnjë proces nuk është i përsosur, prandaj ***ne besojmë se ka një hapësirë për përmirësimin e modelit aktual.***

### ***Ndarja e qeverisjes dhe mbikëqyrjes nga zhvillimi i standardeve***

Në këtë drejtim, ne besojmë se ka nevojë për sqarime të mëtejshme në mes të roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet Grupit të Monitorimit, BMIP-së dhe FNK-së. Duke besuar se kjo qartësi është më tepër një çështje e komunikimit sesa substanca ne do të përqendrohemi në çështje të veçanta mbi të cilat do të mirëpresim më shumë qartësi janë (a) përgjegjësitë e përgjithshme në sistem, (b) mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me proceset dhe vendimet e dakorduara dhe (c) nëse dhe në çfarë mënyre është siguruar interesi publik (nëse është përgjegjësi e përbashkët, atëherë, si ndahen përgjegjësit mes BMIP-së dhe Grupit të Monitorimit).

Rritja e tregtisë ndërkombëtare, rrjedhjet e kapitalit midis vendeve, investimet ndërkombëtare, firmat shumëkombëshe dhe lidhjet dhe kapitali ndërkombëtar tregojnë nevojën për rregullimin financiar global. Vetëm bashkëpunimi dhe rregullimi i fortë ndërkombëtar mund të shërbejë si shtylla kryesore për ekonominë globale. Me synimin për të kontribuar në sigurimin e integritetit, transparencës, efikasitetit të tregjeve financiare dhe në fund të fundit stabilitetit financiar, ShKÇAK është shumë e angazhuar për standarde të forta ndërkombëtare dhe promovon zbatimin e tyre jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon.

Ne inkurajojmë grupin e monitorimit dhe bordin e monitorimit të reflektojnë mbi një model afatgjatë duke marrë parasysh nevojën për një përcaktues teknike të pavarur të standardeve dhe mbikëqyrjen publike.

### ***Mbajtja e dy bordeve të veçanta për auditim dhe siguri, dhe etikë***

Ne mbështesim propozimin e mbajtjes së dy bordeve të veçanta për auditim dhe siguri dhe etikë në bazë të asaj që, megjithëse të ndërlidhura, janë dy fusha të ndryshme. Parimet etike përfshijnë më shumë sesa thjesht pavarësi dhe zbatohen për gamën e gjerë të shërbimeve të ofruara nga kontabilistët profesionistë. Për më tepër, duke pasur dy borde të veçanta, do të tërheqë një numër më të madh të ekspertizës teknike dhe burimeve dhe kjo do të shmangë përgjegjësitë shumë të mëdha të bordit të vetëm dhe gjetjen e anëtarëve të duhur me aftësitë dhe ekspertizën e duhur në të dyja fushat.

Parimet etike janë të zbatueshme për një gamë të gjerë shërbimesh të ofruara nga kontabilistët profesional, prandaj besojmë se dy grupe të standardeve etike nuk do t'i shërbenin qëllimit duke pasur parasysh që kontabilistët profesionistë ofrojnë siguri dhe shërbime të tjera të biznesit në baza ditore.



Organet e ndryshme të përcaktimit të standardeve duhet të përbëhen nga kompetenca të larta teknike të plotësuar nga një proces i fuqishëm për të kërkuar pikëpamjet nga pjesëmarrësit e tregut.

GM-ja duhet të sigurohet që përcaktimi i standardeve i shërben gjithashtu në mënyrë adekuate nevojave të NVM-ve. NVM-të janë ndoshta sektori më i rëndësishëm i ekonomisë globale, duke përbërë pjesën më të madhe të aktivitetit ekonomik të sektorit privat, si dhe gjurmën sociale dhe mjedisore. Modeli i reformuar duhet të pasqyrojë këtë nëse është me të vërtetë të mbrojë interesin publik.

Përvoja dhe ekspertiza e gjerë praktike, duke përfshirë atë nga PVM-të dhe kontabilistët profesionistë që punojnë në NVM-të, është me rëndësi jetike për vendosjen e standardeve që janë efikase dhe me cilësi të lartë, mburrjen me legjitimitetin e përhapur, të përshtatshme për nevojat e biznesit dhe të shoqërisë, dhe të përgjegjshëm ndaj inovacionit dhe ndryshimit të nevojave të tregut dhe pritjeve shoqërore.

### ***Financimi i bordit për përcaktimin e standardeve***

ShKÇAK beson se pavarësia e nevojshme e bordeve mund të forcohet nga fonde më të qëndrueshme dhe të diversifikuara. Një mekanizëm i qëndrueshëm financimi i sjellë dobi përcaktuesve të standardeve dhe BMIP-së duke e lejuar atë të zbatoj programin e tij teknike dhe të tërheqë staf me cilësi të lartë. Gjithashtu ofron siguri më të madhe për juridiksionet që përdorin ose janë në process të miratimit të standardeve ndërkombëtare të cilësisë së tyre. Financimi i mjaftueshëm dhe i pavarur është çelësi për arritjen e këtij objektiv.

Ju lutemi gjeni më poshtë aneksin me përgjigjet në detaje për pyetjet e ngritura. Nëse keni ndonjë pyetje apo sqarim të mëtejshëm, ju lutem mos ngurroni të na kontaktoni.

I juaji sinqerisht,

Nazmi Pllana

Ardiana Bunjaku

Kryetar i Këshillit

Drejtoresh Ekzekutive

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar  
dhe Auditorëve të Kosovës

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar  
dhe Auditorëve të Kosovës



## **ANEKS-ShKÇAK përgjigjet në pyetjet e formuluar në dokumentin konsultativ të GM-së**

### **1. A jeni dakord me fushat kryesore të çështjeve të identifikuara me modelin aktual të përcaktimit të standardeve? A ka çështje shtesë që grupi i monitorimit duhet të marrë parasysh?**

#### **Çështjet kyçe 1-3**

Ne besojmë se struktura e tanishme tre-shtesore e përcaktimit të standardeve ka siguruar mbrojtje të mjaftueshme të interesit publik duke marrë parasysh bashkëpunimin mes sektorit privat dhe atij publik. Përveç kësaj, kjo strukturë ka kontrole dhe balancime të forta në vend për të siguruar që nuk ka ndikim të panevojshëm nga grupet e interesuara. Ne besojmë se të gjitha bordet aktualisht veprojnë në mënyrë të pavarur në interesin publik dhe kanë proces të rregullt të kualitetit të lartë.

Aktualisht janë më shumë se 120 juridiksione anembanë botës, përfshirë Kosovën, që kanë adoptuar direkt ose përdorin standarde të lëshuara nga BSNAS-ja dhe BSNEK-ja. Në këtë dritë konsiderojmë se interesi publik shërbehet mirë dhe adresohet nëpërmjet këtyre standardeve. Ne besojmë se sfondi dhe përvoja e anëtarëve të bordit mund të jenë një mekanizëm i rëndësishëm përforcues në ruajtjen e interesit publik.

Ndonëse mund të ketë shqetësime lidhur me afatet kohore të standardeve, ne mendojmë se procesi aktual i përcaktimit të standardeve është i përshtatshëm dhe me disa përmirësime në procesin e duhur në bashkëpunim me BMIP-në, kjo mund të adresohet me shpejtësi.

### **2. A jeni dakord me parimet mbizotëruese dhe mbështetëse të artikuluara? A ka parime shtesë që Grupi i Monitorimit duhet të marrë në konsideratë dhe pse?**

Ne pajtohemi me parimet e propozuara, megjithatë ne mendojmë se sektori i NVM-ve duhet të merret në konsideratë pasi që NVM-të përbëjnë pjesën më të madhe të ekonomisë globale.

### **3. A keni sugjerime tjera për përfshirje në kornizë për të vlerësuar nëse një standard është zhvilluar për të përfaqësuar interesin publik? Nëse po, cilat janë ato?**

Interesi publik përfshin një koncept të gjerë. Ai përfshin jo vetëm BI-të, por edhe NVM-të, sektorin publik dhe palët e tjera të interesit. Prandaj, procesi standard vënës gjithashtu duhet të marrë parasysh edhe këta sektorë.



**4. A e mbështetni krijimin e një bordi të vetëm të pavarur për të zhvilluar dhe miratuar standardet e auditimit dhe sigurimit dhe standardet etike për auditorët, apo e mbështetni mbajtjen e bordeve të veçanta për auditim, siguri dhe etikë? Ju lutemi shpjegoni arsyetimin tuaj.**

Ne mbështesim propozimin e mbajtjes së dy bordeve të veçanta për auditim, siguri dhe etikë. Megjithëse të ndërlidhura, janë dy fusha të ndryshme. Parimet etike përfshijnë më shumë sesa thjesht pavarësinë dhe zbatohen për gamën e gjerë të shërbimeve të ofruara nga kontabilistët profesionistë. Për më tepër, duke pasur dy borde të veçanta, do të tërheqë një numër më të madh të ekspertizës dhe burimeve teknike dhe kjo shmang përgjegjësitë shumë të mëdha të bordit të vetëm dhe gjetjen e anëtarëve të duhur me aftësitë dhe ekspertizën e duhur në të dyja fushat.

**5. A jeni dakord që përgjegjësia për zhvillimin dhe adoptimin e standardeve edukative duhet të mbetet përgjegjësi e FNK-së? Nëse jo, pse jo?**

Standardet edukative janë zhvilluar nga BSNK-ja, një bord i pavarur standard vënës. Programi i pajtueshmërisë duhet të mbetet në përgjegjësi të FNK-së, nën ombrellën e OPK-së (organizata profesionale e kontabilitetit), prandaj FNK-ja duhet të sigurohet që anëtarët e saj janë në përputhje me kërkesat e DOA-së. Nëse një anëtar i bordit emërohet përmes një komisioni të emërimit të FNK-së, kjo nuk nënkupton që bordi nuk është i pavarur.

**6. A duhet FNK të mbajë përgjegjësinë për zhvillimin dhe miratimin e standardeve etike për kontabilistët profesionistë në biznes? Nëse jo, pse jo?**

Parimet etike janë të zbatueshme për një gamë të gjerë shërbimesh të ofruara nga kontabilistët profesionale, prandaj ne besojmë se dy grupe të standardeve etike nuk do të shërbenin qëllimin duke pasur parasysh se kontabilistët profesionistë ofrojnë siguri dhe shërbime të tjera për bizneset në baza ditore.

**7. A mendoni se Grupi Monitorues duhet të marrë në konsideratë ndonjë mundësi tjetër për reform në lidhje me organizimin e bordeve për përcaktimin e standardeve? Nëse po, ju lutemi shkruani këto në përgjigjen tuaj së bashku me arsyetimin tuaj.**

Në mënyrë që të kemi një proces të besueshëm të vënies së standardeve që ka mbështetjen dhe besimin e publikut, ne konsiderojmë që bordi i përcaktimit të standardeve duhet të jetë përgjegjës për veprimet e tyre. Gjithashtu, organet mbikëqyrëse nuk duhet të ndërhyjnë në vendosjen e standardeve, por vetëm të mbikëqyrin procesin.



**8. A jeni dakord që fokusi i bordit duhet të jetë më strategjik në natyrë? Dhe a jeni dakord që anëtarët e bordit duhet të shpërblehen/paguhen?**

Ne pajtohemi që bordi duhet të jetë më strategjik në natyrë dhe duhet të mbetet i përditësuar me të gjitha zhvillimet dhe inovacionet e lidhura me të, dhe gjithashtu të bashkëpunojë me palët e ndryshme të interesit për të vepruar në mënyrë më efikase dhe efektive. Meqenëse të jesh anëtar i bordit kërkon përkushtim, njohuri, ekspertizë të lartë, të jenë të azhurnuar, sipas mendimit tonë ne mbështesim që anëtarët e bordit duhet të shpërblehen.

**9. A jeni dakord që bordi duhet të miratojë standarde në bazë të shumicës?**

Për të përfaqësuar pikëpamjet e të gjitha grupeve të interesit (përdoruesit, rregullatorët dhe auditorët) dhe pasi që anëtar i bordit përfaqësohet në mënyrë të barabartë nga këto tri grupe, ne propozojmë që vendimet nga bordi duhet të bëhen në bazë të shumicës,  $\frac{3}{4}$  e bordit apo (75 %). Ne besojmë se suksesi i modelit aktual në marrjen e standardeve të miratuara anembanë botës është kryesisht për shkak të kësaj qasjeje të konsensusit.

**10. A pajtoheni me ndryshimin e përbërjes së bordit në jo më pak se dymbëdhjetë (ose më shumë) anëtarë, duke lejuar edhe anëtarët me orar të plotë (një të tretën) dhe me orar të pjesshëm (tre të katërtat)? Apo propozoni një model alternativ? A ka grupe të tjera të interesit që duhet të përfshihen në anëtarësinë e bordit dhe a ka ndonjë faktor tjetër që grupi i monitorimit duhet të marrë parasysh për të siguruar që bordi ka diversitetin e duhur dhe është përfaqësues i palëve të interesit?**

Sipas mendimit tonë ne besojmë se modeli i propozuar prej 1/3 e përfaqësuesve nga rregullatorët, 1/3 nga përdoruesit dhe 1/3 nga profesioni është një qasje e ekuilibruar dhe e përshtatshme për shkak të shumëllojshmërisë së palëve të interesit. Propozimi i 12 anëtarëve mund të mos jetë i mjaftueshëm për të arritur nivelin e diversitetit gjeografik dhe profesional, por ky numër nuk duhet të jetë aq i lartë për të gjeneruar diskutime joproductive dhe vendim-marrje të tej zgjatur.

**11. Cilat aftësi apo attribute duhet të kërkojë grupi i monitorimit nga anëtarëve të bordit?**

Sipas mendimit tonë nuk ka nevojë për ndryshime të rëndësishme në aftësitë dhe atributet nga ato që aktualisht janë duke u aplikuar për anëtarët e bordit standard vënës, të cilët janë kompetentë, profesionistë shumë të kualifikuar në fushat e tyre përkatëse. Për më tepër, ne besojmë se anëtarët e bordit standard vënës dhe këshilltarët teknik duhet të kenë përvojë dhe ekspertizë PVM/NVM.

Ne mbështesim propozimin që kryetari i bordit nuk duhet të vijë me prapavija nga firma e auditimit.



**12. A pranoni të ruhet koncepti i një grupi këshillues konsultativ me rolin dhe fokusin aktual, ose a duhet ndryshuar përgjegjësia dhe anëtarësia e tyre, dhe nëse po, si?**

Duke pasur parasysh se numri i anëtarëve të bordit propozohet të reduktohet në 12 anëtarë, ne besojmë se roli i grupeve këshilluese konsultative (GKK) është i domosdoshëm duke zgjeruar rrjetin e profesionistëve që ofrojnë inpute dhe këshilla të mëtejshme në aktivitetet e bordit.

Grupet këshilluese konsultative (GKK) përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procesit të përgjithshëm dhe përpjekjeve konsultative. Më shumë mund të jepet për të rritur transparencën e vetë GKK-së, për shembull, procesin e emërimeve dhe transparencën rreth diskutimeve të GKK-së dhe mënyrën se si pikëpamjet e GKK-së trajtohen nga çdo bord.

**13. A pajtoheni se task forcet që përdoren për të ndërmarrë punë të hollësishme zhvillimore duhet t'i përmbahen Kornizës së interesit publik?**

Rolet dhe përbërjet e grupeve punuese/ task forcave duhet të përcaktohen dhe ne besojmë se grupet e punës apo grupet e ekspertëve duhet të përfaqësojnë një gamë të ndryshme të ekspertizës dhe palëve të interesuara dhe duhet të jenë shumë kompetentë në fushat varësisht nga çështjet që duhet të adresohen.

**14. A jeni dakord me ndryshimet e propozuara për procesin e emërimit?**

Ne nuk shohim ndonjë ndryshim të nevojshëm për procesin e tanishëm të emërimit, sepse siç propozohet në dokumentin e konsultimit, BMIP (Bordi i Mbikëqyrjes së Interesit Publik) mund të ketë një konflikt interesi duke pasur rolet e qeverisjes dhe mbikëqyrjes.

**15. A jeni dakord me rolin dhe përgjegjësitë e BMIP-së siç përcaktohen në këtë document konsultimi? A duhet që BMIP-ja të jetë në gjendje të vërë veton për miratimin e një standardi, ose të sfidojë gjykimet teknike të bëra nga bordi në zhvillimin ose rishikimin e standardeve? A ka përgjegjësi të mëtejshme që duhet t'i caktohen BMIP-së për të siguruar që standardet janë vendosur në interesin publik?**

Duke i'u referuar komentit tonë në pyetjen 7, ne besojmë se BMIP-ja duhet të jetë orang me shumë palë të interesuara me përgjegjësinë për të mbikëqyrur punën e bordit, por jo për të ndërhyrë në aspektin teknik të procesit të standard vënies. Ne nuk e mbështesim veton në asnjë nga proceset.



**16. A jeni dakord me opsionin për të hequr përfaqësimin e FNK-së nga BMIP-ja?**

Jo ne nuk pajtohemi.

Ne besojmë se FNK-ja duhet të jetë në gjendje të vazhdojë të emërojë anëtarë për miratim nga GM, për emërim në BMIP. Në këtë drejtim është e rëndësishme që të ketë përfaqësim të balancuar të t gjitha palëve të interesuara në BMIP përfshirë njerëzit me njohuri dhe ekspertizë të lartë të auditimit dhe kontabilitetit.

**17. A keni sugjerime lidhur me përbërjen e BMIP-së për të siguruar që ai të jetë përfaqësues i palëve jo-praktikuese dhe cilat aftësi dhe atribute duhet të kenë anëtarët e BMIP-së?**

BMIP-ja duhet të përbëhet nga jo-praktikues me një sfond dhe ekspertizë të auditimit, sigurimit, pavarësisë dhe etikës, me qëllim të mbikëqyrjes së procesit të standard vënies dhe bordit standard vënës. Disa anëtarë të bordit duhet të kenë gjithashtu njohuri akademike. Anëtarët duhet të përfaqësojnë diversitet gjeografik dhe diversitet të aftësive.

**18. A mendoni se anëtarët e BMIP duhet të vazhdojnë të emërohen përmes anëtarëve individualë të grupit monitorues, apo anëtarët e BMIP-së duhet të identifikohen përmes një thirrjeje të hapur për emërim nga organizatat anëtare të grupit të monitorimit, apo keni sugjerime të tjera lidhur me procesin e emërimit / caktimit?**

Ne nuk pajtohemi me emërimet përmes anëtarëve të MG-së, kështu që ne sugjerojmë që procesi i emërimit të jetë një thirrje e hapur, publike dhe transparente, me qëllim që të përfshijë gamë të ndryshëm të grupeve.

**19. A duhet që mbikëqyrja e BMIP-së të përqendrohet vetëm në bordin e pavarur standard vënës për standardet e auditimit dhe sigurimit dhe standardet etike për auditorët, apo duhet të vazhdojë të mbikëqyrë punën e bordeve të tjera të përcaktimit të standardeve (p.sh., lëshimi i standardeve arsimore dhe standardeve etike për kontabilistët profesionistë në biznes) ku vendosin standarde në interes të publikut?**

Ne nuk pajtohemi të ndryshojmë modelin aktual, siç kemi përmendur tashmë se modeli është i përshtatshëm për qëllimin dhe mund të ketë vetëm disa përmirësime.





**20. A jeni dakord që Grupi i Monitorimit të mbajë rolin e tij aktual të mbikëqyrjes për të gjithë procesin e përcaktimit dhe mbikëqyrjes së standardeve duke përfshirë monitorimin e zbatimit dhe efektivitetit të reformave, emërimin e anëtarëve të BMIP-së dhe monitorimin e punës së tij, promovimin e standardeve të cilësisë së lartë dhe mbështetjen e llogaridhënies publike?**

Ne mbështesim modelin aktual, përveç emërimit të anëtarëve të BMIP-së (duke iu referuar përgjigjes në pyetjen 18).

**21. A pajtoheni me opsionin për të mbështetur punën e bordit të vendosjes së standardeve me një staf teknik të zgjeruar profesional? A ka aftësi specifike që një bord i ri i vendosjes së standardeve duhet të kërkojë të marr?**

Ne pajtohemi me opsionet e propozuara, por kemi propozuar në mënyrë specifike që stafi teknik të ketë sfondin dhe ekspertizën e PVM-ve dhe NVM-ve.

**22. A jeni dakord që stafi i përhershëm duhet të jetë i punësuar drejtpërdrejt nga bordi?**

Ne pajtohemi që stafi i përhershëm të jetë i punësuar nga bordi, por kjo ngre shqetësime rreth bërjes së një personi juridik dhe gjithashtu çështjeve të financimit.

**23. A ka fusha të tjera në të cilat bordi mund të bëjë përmirësime në proces - nëse po, cilat janë ato?**

- Përmirësimi i procesit për të siguruar afatet kohore të standardeve
- Përacktimi i objektivave të qarta kur një standard duhet të rishikohet ose të nxirret.
- Rishikimi i çdo standardi në një afat kohor të qëndrueshëm

**24. A jeni dakord me grupin e monitorimit që kontrole të përshtatshme dhe bilancime mund të vihen në vend për të zbutur rrezik për pavarësinë e bordit si rezultat i financimit të saj pjesërisht nga firmat e auditimit ose nga profesioni i kontabilitetit (p.sh. miratimi i pavarur i buxhetit nga BMIP-ja, duke siguruar fondet për një fond të veçantë ose BMIP-ja të shpërndaj fondet)?**

Modeli i financimit duhet të përfaqësojë grupet e interesit.

Modeli i propozuar i financimit duke paguar taksat nga firmat e auditimit do të thellonte perceptimin e ndikimit të panevojshëm nga profesioni në procesin e standard vënies.



**25. A e mbështesni aplikimin e një takse "kontraktuale" në profesion për financimin e bordit dhe BMIP-së? Për çfarë periudhe duhet të vendoset kjo taksë? A duhet që grupi i monitorimit të marrë parasysh ndonjë mekanizëm shtesë financimi, përtej atyre të propozuara në dokument, dhe nëse po, cilat janë ato?**

Referohuni pyetjes 24.

**26. Sipas mendimit tuaj, a ka ndonjë çështje që grupi i monitorimit duhet të marrë parasysh në zbatimin e reformave? Ju lutem përshkruani.**

Ne nuk kemi ndonjë çështje tjetër përveç atyre të përmendura në pyetjet e mëparshme.

**27. A keni ndonjë koment apo sugjerim të mëtejshëm për të bërë që grupi i monitorimit duhet të marrë në konsideratë?**

Ne nuk kemi ndonjë koment shtesë. Sugjerimet përkatëse përfshihen në përgjigjet e pyetjeve.